



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2214/ 14 prot.

Datë 10.11.2025

V E N D I M
Nr. 1634/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1443/2025, datë 14.10.2025, për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, shërbim, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, me Nipt M38106801F, Adresa: BARAJ 01960008 Nd. 64, H. 1, Mallakastër.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Belsh
Adresa: Belsh, Qendër.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 14.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1443/2025, ku vendosi:

1. *Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, shërbim, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, shërbim, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera me publikimin e shtojcës në zbatim të Vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me shërbim postar, datë 22.10.2025, protokolluar me tonën me Nr. 2214/9, datë 24.10.2025, drejtuar Ak-së dhe për dijeni KPP-së, Operatori ekonomik ka përcjellë kërkesë për zbatim vendimi, në lidhje me modifikimet e kryera nga Autoriteti kontraktor me shtojcën e datës 21.10.2025, publikuar në SPE për kriteret 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.6.

I.3. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr. 3634/1 prot., datë 23.10.2025, protokolluar me tonën me Nr. 2214/10, datë 27.10.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë Shtojcën Nr. 2963/3 Prot., datë 21.10.2025, Mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit sipërcituar, me anë të së cilës informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1443/2025, datë 14.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar .

I.4. Me shkresën ardhur me nr. 3719/1 prot., datë 27.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2214/11 prot., datë 30.10.2025, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik, në lidhje me zbatimin e vendimit nr.1443/2025, datë 14.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr. 3634/1 prot., datë 23.10.2025, protokolluar me tonën me Nr. 2214/10, datë 27.10.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë Shtojcën Nr. 2963/3 Prot., datë 21.10.2025, Mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit sipërcituar, me anë të së cilës informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1443/2025, datë 14.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar .

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën përkatëse për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, *Bashkia Belsh* ka zbatuar vendimin Nr.1443/2025, datë 14.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e Thjeshtuar” shërbim, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

